

# ANALIZA E PUNËS SË KSHPK NË PJESËN PËR KONTROLLIN E INTERESAVE DHE PRONË NË GJYSMËN E PARË TË VITIT 2020

Autor: Aleksandar Bozhinovski



Projekti "Monitorimi i Suksesit të Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni" është financuar nga Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni. Përmajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe e grantit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni.

# Impresum

---

**Titull:** ANALIZA E PUNËS SË KSHPK NË PJESËN PËR  
KONTROLLIN E INTERESAVE DHE PRONË NË  
GJYSMËN E PARË TË VITIT 2020

**Autor:** Aleksandar Bozhinovski

**Botues:** Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

**Design:** Matea Londza Shumkovska

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

<http://www.antikorupcija.mk/>

Projekti "Monitorimi i Suksesit të Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni" është financuar nga Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni.

Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe e grantit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni.



Analiza i referohet vendimeve të cilat i ka miratuar Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin më tutje KSHPK) pas procedimit të lëndëve në lidhje me kontrollin e interesave dhe pronës së bartësve të funksioneve publike në gjysmën e parë të vitit 2020.

Në pajtim me Ligjin,<sup>1</sup> çdo person i zgjedhur ose i emëruar dhe person përgjegjës në ndërmarrje publike ose person tjetër juridik që ka kapital shtetëror, në afat prej 30 ditë nga fillimi në funksion është i detyruar të paraqesë deklaratë mbi gjendjen pronësore dhe interesat. Në rast të ndryshimit të gjendjes pronësore, personat që kanë kapital shtetëror, brenda 30 ditëve, duhet të paraqesin ndryshimin në KSHPK.<sup>2</sup> Për të dhënat e siguruara, Komisioni Shtetëror mban baza të të dhënave për gjendjen pronësore dhe interesat, ndërsa të dhënat nga deklaratat për gjendjen pronësore përbëjnë informacion me karakter publik, përveç të dhënave të mbrojtura me ligj. Të dhënat publikohen dhe azhurnohen rregullisht në ueb-faqen e Komisionit Shtetëror.<sup>3</sup>

Verifikimi i vërtetësisë së të dhënave nga lista anketuese bëhet me aplikim, iniciativë vetanake (pas pranimit të informatës) ose bazuar në planin vjetor për ndjekjen e gjendjes pronësore dhe interesave. Listat anketuese dhe formularët për ndryshimin e gjendjes pronësore paraqiten në formë të shtypur, pas së cilës të dhënat prej vendosen në bazën elektronike të KSHPK-së nga nëpunës administrativ të punësuar dhe publikohen në ueb faqen KSHPK-së.

Procedura për përcaktimin e besueshmërisë së të dhënave është e gjerë dhe përfshin disa hapa. Procedura fillon me formimin e lëndës mbi një denoncim të paraqitur ose sipas iniciativës vetanake. KSHPK-ja, u drejtohet personave që i nënshtrohen verifikimit të paraqesin të dhëna për anëtarët e familjes me të cilët jetojnë në ekonomi familjare të përbashkët. Pas sigurimit të këtyre të dhënave, KSHPK-ja, kërkon informacion nga disa institucione, përfshirë Agjencinë për Kadastër të Patundshmërive, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Depozitarin Qendror të Letrave me Vlerë, Regjistrin Qendror dhe Drejtorinë e të Ardhurave Publike me kërkesë për paraqitjen e të dhënave për pronën. Në raste të caktuara, KSHPK-ja, mund të kërkojë të dhëna nga bankat dhe institucionet e tjera financiare.

Sipas hulumtimit të Metamorfozës në prill 2020,<sup>4</sup> Komisioni shtetëror përballet me një sërë probleme. Këtu janë, para së gjithash, stafi i pamjaftueshëm dhe qasje automatike pothuajse jofunksionale në bazat e të dhënave të institucioneve të tjera. KSHPK ende mbështetet në shpejtësinë e përgjigjes nga institucionet e tjera ndaj të dhënave të kërkuara. Në gjysmën e parë të vitit 2020, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme dhe pandemisë me Covid-19, këto mangësi bëhen edhe më të rëndësishme. Problemi vazhdon edhe më tutje,<sup>5</sup> ndërsa është e sigurt se edhe në vitin 2021 KSHPK-ja, nuk do të ketë lidhje të plotë ndërvepruese.

<sup>1</sup> Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, Gazeta Zyrtare, nr.12/2019 neni 82

<sup>2</sup> IBID, neni 85

<sup>3</sup> Të dhëna nga Listat anketuese mbi gjendjen pronësore të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar. Mundësuar në: <https://www.dksk.mk/index.php?id=35>

<sup>4</sup> Teofil Bilazhevski dhe Rizaov Goran. "Reforma në anti-korrupsion dhe lufta kundër krimit të organizuar: Komisioni anti-korrupsion - një nga pak dritat në tunel" 2020. Në dispozicion në: <https://metamorphosis.org.mk/wp-content/themes/metamorphosis/download.php?id=25618>


<sup>5</sup> David Ilievski "Zyrtarë të komoditetit, anti-korrupsion i izoluar" 2020 <https://irl.mk/komotni-funksioneri-izolirani-antikorupsioneri/>

## Analiza e të dhënave


Në harkun kohor që është subjekt i këtij studimi (gjysma e parë e vitit 2020, përkatësisht nga seanca e 27-të deri në seancën 31), KSHPK shqyrtoi 15 lëndë të llojit të kontrollit të interesave dhe pronës, ku shtatë raste u iniciuan nga KSHPK ose pothuajse 50% e numrit të përgjithshëm. Nëntë nga lëndët i referohen

shkeljes "mosparaqitja e listës anketuese" nga person i zgjedhur ose emëruar. Një rast ka të bëjë me kontrollin e pasurisë së funksionarëve; hulumtimin e origjinës së pronës dhe konflikt interesi, dhe tre raste janë pjesë e planit vjetor për ndjekjen e gjendjes pronësore dhe interesat e Komisionit.

Lëndë



- Për planin vjetor per ndjekjen e gjendjes pronësore dhe interesat 22%
- Origjina e pronës 7%
- Kontrolli i pronës së funksionarëve 7%
- Mos paraqitja e Listës anketuese 64%



Koha mesatare për zgjidhjen e lëndëve është 212 ditë. KSHPK për 10 nga 15 raste ose për 75%, ka paraqitur kallëzim për kundërvajtje, por të gjitha kallëzimet ishin për "mosdorëzimin e listës anketuese", përveç një për të cilën është konstatuar konflikt interesi.

Kjo duhet të jetë, të paktën administrativisht, pjesa më e lehtë e punës së saj. Megjithatë, KSHPK-së i duhen mesatarisht 7 muaj për të vendosur nëse ndonjë funksionar në kohë dhe në mënyrë korrekte

ka dorëzuar listën anketuese për pronën e tij ose jo. Mirëpo, për pjesën tjetër në digjitalizimin e paraqitjes së listës anketuese dhe numrin e punonjësve që janë të angazhuar për detyrën, zvogëlon efikasitetin e procesit. Ekziston gjithashtu problem në informacionin e vjetëruar të KSHPK-së nga institucionet që emërojnë, kur do të ndodhin ndryshimet. Së këndejmi, kontrolli i obligimeve për plotësimin e listës anketuese është vështirësuar.



## Përfundime dhe rekomandime

---

Kontrolli i interesave dhe pronës është pjesë thelbësore në luftën kundër korrupsionit dhe në punën e Komisionit. Prandaj është e nevojshme që KSHPK-ja, të ketë rezultate më të mira në këtë fushë.

Ajo që shihet qartë nga shtjellimi i këtij raporti të KSHPK-së (në pjesën e kontrollit të interesave dhe pronës), si dhe nga pjesa tjetër e literaturës, është se rreth dy të tretat e punës së saj në këtë fushë kanë të bëjnë me dorëzimit jo në kohë të listës anketuese. Shihet se kohëzgjatja për zgjidhjen e lëndëve për kontrollin e pronës dhe interesave, KSHPK-ja, punon shumë gjatë. Kohëzgjatja ka efekt shumë negativ

mbi imazhin publik të KSHPK-së, dhe kjo duhet të korrigohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Është e nevojshme të rritet kapaciteti i KSHPK-së, në një periudhë kur nuk dihet kur do të kompletohet ndërveprimi me bazat e të dhënave të Regjistrat Qendror, Depozitarit Qendror të Letrave me Vlerë, Doganës, Drejtorisë së Evidencës amë, DAP, etj. Kjo do të thotë që ndërkohë është e nevojshme të angazhohen në mënyrë proaktive dhe të rritet numri i të punësuarve në KSHPK, detyra e të cilëve do të jetë kontrolli dhe vërtetimi i pronës së deklaruar.

